



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 20  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302  
Prishtinë, më 4 korrik 2018, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Haxhi Avdyli, Flora Brovina, Time Kadrijaj dhe Drita Millaku.

**Munguan:** Naser Rugova, Bekim Haxhiu dhe Fikrim Damka.

**Pjesëmarrës tjerë:** Artan Murati dhe Gentian Berbati- KDI dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi,** Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut;
3. Shqyrtimi i projektligjit për ndërmarrjet sociale;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

**2. Shqyrtimi i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut**

**Kryetarja** tha se ky Projektligj ka kaluar të gjitha fazat e parapara me rregullore dhe pas kësaj mbledhje do të procedohet për miratim në Kuvend. Nga komisionet kryesore nuk ka ndonjë vërejtje, kemi vetëm një kërkesë nga inspektorati shëndetësor që në amendamentin 48, të tërhiqet fjala që e kemi fshirë, pra fjala „ mjek” dhe të mbetet si në Projektligj. Kjo kërkohet me arsyen se nuk ka kuadro të mjaftueshëm specialistë të transfuzionit, prandaj inspektori mund të jetë vetëm mjek i përgjithshëm.

Pas diskutimit komisioni u pajtua që amendamenti 48 të ndryshohet, dhe fjala „doktor” të fshihet nga amendamenti dhe të mbetet teksti si në Projektligj.

Komisioni për shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale njëzëri miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin për gjak dhe përbërës të gjakut, dhe e procedoi për miratim në Kuvend.

### **3. Shqyrtimi i projektligjit për ndërmarrjet sociale**

**Kryetarja:** Grupi punues ka punuar një kohë të gjatë në këtë Projektligj dhe i ka përfunduar amendamentet. Ju prezantoj amendamentet e grupit punues në vazhdim:

**Kryetarja:** Pas miratimit të amendamenteve, do t'i procedojmë te komisionet e përhershme dhe do të kërkojmë që edhe ato në afat sa më të shkurtër t'i përfundojnë, dhe të shpresojmë që brenda këtij sesiioni edhe ky Projektligj të miratohet.

**Haxhi Avdyli:** Ky ligj është një ligj shumë i rëndësishëm dhe duhet pasur kujdes të monitorohet gjatë implementimit. Pra duhet gjetur edhe mekanizmat implimentues. Ne e pamë gjatë vizitës në Shqipëri se atje ligji nuk ishte zbatuar në mungesë të mekanizmave implementues. Nëse shteti nuk i përkrah financiarisht ndërmarrjet sociale dhe nëse nuk ka fushata informuese se çka janë ndërmarrjet sociale, nuk besoj që do kenë sukses.

**Kryetarja:** Pajtohem që ka shumë ligje që kalojnë në Kuvend, e qytetarët nuk janë të njoftuar me to. Qeveria duhet të bëjë fushata njoftuese për ligjet e reja që hyjnë në fuqi. Edhe ne, si deputetë duhet ta japim kontributin tonë në këto fushata vetëdijesuese. Kemi informata se ka edhe një donacion të BE- së prej 2 milionë euro, i cili do t'i ndihmojë fillimisht kësaj ndërmarrje.

**Fatmire Mulhaxha – Kollçaku:** Besojmë se ky ligj do t'i ndihmojë dhe do t'i favorizojë grupet e cenueshme. E dimë se shumë njerëz nuk janë aktivë në kërkim të punës, e sidomos në regjistrimin si të pa punë, prandaj në fushatën vetëdijesuese duhet të përfshihet edhe vetëdijesimi i të papunëve që të shkojnë dhe të lajmërohen si të pa punë.

**Flora Brovina:** Ligji ka qenë një ligj i vështirë për t'u miratuar, besoj që ne nga shkëmbimi i përvojave edhe me të tjerët e kemi miratuar edhe më shpejt se vendet e tjera të rajonit. Tani varet nga Qeveria se sa do t'i ndërtojë mekanizmat për implementim të këtij ligji duke filluar nga inkubatorët dhe mekanizmat e tjerë të nevojshëm. Kuvendi e ka për detyrë të monitorojë zbatimin e ligjeve, prandaj do ta bëjmë monitorimin edhe të këtij ligji.

**Enver Hoti:** Duhet përshëndetur Qeveria për sponsorimin e këtij ligji. Ne kemi punuar me përkushtim në këtë ligj, tani duhet ta përcjellim zbatimin e tij. Nuk besoj që ky ligj do ta zbutë në masë të madhe papunësinë, por mendoj se duhet të bëjmë më shumë në zbatimin e Ligjit të punës.

Pas diskutimeve dhe leximit të amendamenteve, komisioni njëzëri votoi të gjitha amendamentet një nga një, dhe votoi edhe raportin me amendamentet, të cilin e procedon për komisionet e përhershme.

### **3. Të ndryshme.**

**Kryetarja:** Ju ftoj t'i paraqisni kërkesat tuaja për takimet e radhës.

**Flora Brovina:** Për këtë pikë mendoj që në takim me ministrin e punës duhet të diskutojmë Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili po ka shumë kërkesa nga qytetarët se është një ligj diskriminues, dhe nuk po ju jap mundësi njerëzve që t'i fitojnë pensionet.

Gjithashtu duhet kërkuar nga ministri të na njoftojë se çfarë është duke u punuar për shtesat e fëmijëve.

Shqetësuese është edhe çështja e ikjes së mjekëve nga Kosova dhe për këtë çështje duhet ta organizojmë një tryezë ku do të diskutojmë për ikjen e kuadrove nga Kosova.

**Kryetarja:** Kemi shumë çështje që duhet t'i adresojmë me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por edhe me Ministrin e Shëndetësisë.

**Haxhi Avdyli:** Ne duhet të kemi strategji për resurset humane. Në kornizën afatmesme deri në vitin 2020 nuk ka rritje të të punësuarve në shëndetësi.

**Kryetarja:** Kur ta rishqyrtojmë planin e punës së komisionit, do t'i planifikojmë edhe tryezat edhe vizitat që do t'i bëjmë. Për mbledhjen e radhës do ta ftojme ministrin e Shëndetësisë, e pastaj edhe ministrin e Punës.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**